




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



INSTITUTI I SIGURIMEVE  
SHOQËRORE

Nr. 4473, Datë 19/5 /2017

DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E TATIMEVE

Nr. 11622, Datë 19/5 /2017

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot më datën \_\_\_\_\_, në Tiranë, ndërmjet palëve:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, më poshtë i quajtur "ISSH", i krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 249, datë 05.06. 1992, "Për krijimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore", me adresë: Rruga e Durrësit, nr.83, Tiranë, përfaqësuar nga Astrit Hado me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, më poshtë e quajtur "DPT", me adresë Rruga "Gjin Bue Shpata" Tiranë, përfaqësuar nga Vasilika Vjero, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm.

Palët e mësipërme bien dakord të lidhin këtë marrëveshje me kushtet si më poshtë:

#### I. Qëllimi i marrëveshjes.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është ripercaktimi i detyrave dhe komunikimeve midis DPT dhe ISSH, lidhur me procedurat dhe rregullat për dërgimin apo transferimin në formë elektronike të informacionit për pagesat e kontributeve sipas subjekteve dhe individeve, komunikimin midis palëve të të dhënave statistikore dhe problematikave që dalin pas inspektimit nga ISSH, të të dhënave të kontributeve të procesuara në llogaritë individuale. Gjithashtu qëllimi i marrëveshjes është edhe plotësimi i mungesave të konstatuara në listëpagesat në format shkresor (letër), të personave juridike, të listëpagesave dhe të dhënave për pagesat e kontributeve nga personat fizike, si dhe të pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore nga subjektet, për periudhat e "pa informatizuara".

## II. Objekti i marreveshjes.

- a) Dërgimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në Institutin e Sigurimeve Shoqërore sipas “Protokollit të Komunikimit Elektronik të listëpagesave, për të dhënat e listëpagesave të subjekteve dhe raportet statistikore të tyre”, dhe konkretisht:
  - i. transferimin on-line të të dhënave të listëpagesave mujore të kontibuteve të sigurimeve shoqërore të deklaruara nga subjektet,
  - ii. dërgimin në format elektronik të të dhënave për kontributet e paguara çdo muaj nga çdo subjekt,
  - iii. dërgimin në format elektronik të të dhënave përmbledhëse të listëpagesave dhe raportet statistikore që lidhen me to,
  - iv. dërgimin në format elektronik të të dhënave për detyrimet kontributive progresive të papaguara për çdo subjekt debitor.
- b) Bashkepunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për shkëmbimin dhe përdorimin e informacionit të mbledhur nga sistemet elektronike të deklarimit dhe pagesave të kontributeve, nga subjektet juridikë dhe fizikë, duke mundësuar:
  - i. kontrollin dhe verifikimin e shumave të kontributeve të paguara nga subjektet,
  - ii. rakordimin e kontributeve të paguara në bankë me listëpagesat e dërguara në format elektronik,
  - iii. trajtimin e problematikave të mbartura lidhur me dërgimin e listëpagesave të munguara të formatit letër.
- c) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore i realizojnë marrëdhëniet institucionale dhe administrative ndërmjet Drejtorive Qëndrore të tyre.

## III. Baza ligjore.

- ✓ Ligji nr.7703, dt 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr.9136, dt 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9920, dt 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Pika 1, e kreut të VI-t, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.77, datë 28.1.2015, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”;
- ✓ Pikat 4 dhe 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.922, dt 29.12.2014, “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”;

- ✓ Pjesa 5, e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.23, datë 9.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”;
- ✓ Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.2, dt. 6.2.2012, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- ✓ Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 21, datë 1.3.2017, “Për ngritjen e grupit të punës lidhur me përgatitjen e projekt marrëveshjes midis Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me objekt transmetimin e të dhënave të listëpagesës dhe të dhënave të tjera për kontributet”;

#### IV. Detyrimet e Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore si dhe në mbështetje të dokumentit “Protokoll i Komunikimit Elektronik të listëpagesave”, dërgon on-line:
  - a) Listëpagesat për çdo NIPT, me të dhënat sipas të gjitha rubrikave, për çdo person, të identifikuar me numrin personal, shumën e kontributeve e të cilave është derdhur plotësisht;
  - b) Shumat e kontributeve, të kamatvonesës dhe të gjobave për mos pagim në afatet ligjore të kontributeve, të paguara sipas NIPT-eve, sipas muajve, datave të pagesës dhe bankës ku është bërë derdhja;
  - c) Shumat e kontributeve të transferuara (me transferata të brendshme) nga një periudhë në tjetren, sipas NIPT-eve, muajve, dates së transferimit.
  - d) Të dhënat e mësipërme transmetohen edhe për çdo version të fundit të ndryshuar të listëpagesës;
2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dërgon zyrtarisht në Institutin e Sigurimeve Shoqërore në formë elektronike apo në format letër, të dhënat mujore dhe të dhënat progresive përmbledhëse të deklarimeve dhe të pagesave, si dhe raporte statistikore, si më poshtë:
  - a) Në formë elektronike;
    - Evidenca, “Raporti i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore”, Kodi 2 DPTH”, në total dhe sipas drejtorive rajonale tatimore, në version mujor dhe progresiv.
    - Numrin total të subjekteve sipas aktiviteteve e rajoneve dhe numrin e kontribuesve në këto subjekte. Raportet për numrin e subjekteve dhe numrin e kontribuesve dërgohen çdo tre muaj.
    - Raportin analitik të debitorëve për sigurimet shoqërore, kamatvonesës e gjoba, për çdo tatimpagues, në shumë progresive. Raportet për debitorët dërgohen çdo tre muaj.
  - b) Në format letër:
    - Në fillim të çdo viti, treguesit e programimit për të ardhurat kontributive, numrin e subjekteve aktive, numrin e kontribuesve të punësuar në këto subjekte, fondin e pagave

mbi të cilën derdhen kontributet dhe pagën mesatare vjetore mbi të cilën llogariten të ardhurat kontributive sipas subjekteve dhe të ndarë sipas Drejtorive Rajonale Tatimore dhe të detajuar mujor dhe vjetor.

Listëpagesat e padërguara në ISSH nga administrata tatimore, të periudhave nga Tetori 2003 deri në 31.12.2011, ku deklarimi dhe levizja e dokumentacionit nga subjekti në organet tatimore dhe në Drejtoritë e Sigurimeve Shoqërore, bëhej sipas formës, mënyrës dhe rregullave në fuqi në periudhat tatimore përkatëse.

#### V. Detyrime të Institutit të Sigurimeve Shoqërore

1. Pasi merr zyrtarisht të dhënat përmbledhëse në mënyrë koherente on line të listëpagesave dhe kontributeve të likujduara, të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për çdo subjekt tatim pagues dhe individ, ISSH i transferon ato në regjistrin elektronik të historikut individual kontributiv, duke i pozicionuar ato në kartelë individuale për çdo kontributpagues.
2. Pasi merr zyrtarisht në format leter apo në format elektronik, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të gjithë listëpagesat të padorëzuara, që i përkasin periudhave tatimore 2003-2012, ISSH kryen inventarizimin e tyre në bashkëpunim me DRSSH dhe DRT, dhe më pas i sistemon ato në dosjet e subjektit përkatës si dhe në kartelat individuale të historikut kontributiv, për çdo kontributpagues.
3. Pasi merr zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të dhënat përmbledhëse në format elektronik, të të gjithë listëpagesave të padorëzuara, që i përkasin periudhave tatimore 2012 dhe vazhdim, ISSH kryen transferimin në regjistrin elektronik të historikut individual kontributiv, duke i pozicionuar ato në kartelë individuale për çdo kontributpagues.
4. Instituti i Sigurimeve Shoqërore informon kontribuesit, në vazhdim, për kontributet vjetore në total dhe të ndara në muaj, të paguara nga ai ose për llogari të tij.
5. Në çdo rast të konstatimeve të mundshme për çdo anomali apo problem, bazuar tek transmetimi i listëpagesave dhe të dhënave kontributive individuale, ISSH njofton zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

#### VI. Të perbashketa

1. Për zbatimin e kësaj marrëveshje, procedura teknike në komunikimin on-line, midis sistemeve informatike të ngritura në të dy institucionet, bazohet në Protokollin e Komunikimit Elektronik të listëpagesave.
2. Për të zgjidhur problematikat konkrete lidhur me evidentimin e të dhënave të kontributeve të personave që i përkasin vitit 2016, transmetimi i tyre mund të bëhet në formate të tjera elektronike, të miratuara si, Schema Buffer për të dhënat e listëpagesave.

3. Me qëllim të evidentimit të kontributeve të paguara, konstatimit të listëpagesave të munguara të paguara dhe zbatimin e masave të plotësimit të të dhënave të kontribut paguesve me listëpagesat e munguara të periudhës 2003-2011 dhe me kontributet individuale të paguara, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve vë në dispozicion të ISSH;
  - a. në format elektronik - nga baza e të dhënave sipas sistemit informatik të periudhës; pagesat e kryera nga subjektet të evidentuara sipas nipteve dhe instrumentit të pagesës, të dhënat për kontributet e deklaruara dhe të paguara sipas periudhës tatimore, për çdo nipt, të dhënat përmbledhëse të listëpagesave sipas nipteve dhe sipas periudhave tatimore. Formatimi i të dhënave të sipërshënuara dhe mënyra e transmetimit nga DPT në ISSH, me qëllim ruajtjen e pandryshueshmërisë, përcaktohet në protokoll midis paleve, i cili bëhet pjesë e kësaj marrëveshje.
  - b. të dhëna të hedhura manualisht në regjistra- të përpunuara nga dëget e tatimeve të pa informatizuara, nga viti 2003 deri në vitin 2009. Drejtoritë Rajonale Tatimore vënë në dispozicion të personave të autorizuar të drejtorive të ISSH në Qarqe, regjistrat manualë të sektorit të vlerësimit dhe regjistrat e financë-kontabilitetit ku janë të evidentuar detyrimet për kontributet, vlerësimet, pagesat, numri i kontribuesve etj, me qëllim skanimin e tyre dhe krijimin në arkivat e ISSH të një baze të dhënash dixhitale. Procesi i skanimit kryhet nga punonjësit e autorizuar të Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore nën kujdesin e personelit të Drejtorise Rajonale Tatimore.
4. Për listepagesat e dërguara në strukturat e sigurimeve shoqërore për të cilat shuma e detyrimit për kontributet e sigurimeve shoqërore është likujduar plotësisht, vërtetimet për kontributet e paguara, sipas kërkesave të individëve, duke filluar nga data 1 Qershor 2017, jepen zyrtarisht nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ndërsa kur listëpagesa e sigurimeve shoqërore nuk është paguar nga subjekti apo nuk është dërguar ende në strukturat e Sigurimeve Shoqërore, kërkesat për vërtetime adresohen në Drejtoritë Rajonale Tatimore, të cilat rezlizojnë edhe plotësimin i vërtetimeve zyrtarisht.
5. Lëshimi i vërtetimeve për kontributet, sipas kërkesave nga çdo subjekt tatimpagues (person juridik ose fizik), në çdo rast, për një periudhë prej 3(tre) muaj nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, kryhet vetëm nga strukturat tatimore, të cilat administrojnë dhe ndjekim llogaritë e subjektit në marrëdhënie me tatimet. Palët më pas mund të rishqyrtojnë këtë pikë.
6. Pjesë e pandarë e kësaj marrëveshje është dokumenti “Protokolli i Komunikimit Elektronik të listëpagesave”, i nënshkruar midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

7. Për zbatimin e kësaj marrëveshje, ISSH dhe DPT, përveç zyrave të tyre qendrore, ngarkojnë edhe drejtoritë rajonale në vartësi të tyre. ISSH dhe DPT, në funksion të zbatimit të kësaj marrëveshje, caktojnë personat përgjegjes dhe personat e kontaktit në zyrat e tyre qendrore dhe për çdo drejtori rajonale, të cilëve u specifikohen detyrat, afatet si dhe përgjegjësitë.
8. Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve bashkëpunojnë për zbatimin me korrektësi të kësaj Marrëveshje si dhe për zgjidhjen e problemeve që mund të krijohen nga moszbatimi i saj.
9. Në rastet kur është e nevojshme të rishikohet Marrëveshja, për përmirësime të mëtejshme, apo ndryshime, ato do të finalizohen në Aneks Marrëveshje shtesë, sipas dakortësisë të të dy palëve.
10. Memorandumi midis dy institucioneve, me nr. 1009/1, datë 10.03.2010, "Për transmetimin në mënyrë elektronike të të dhënave të listëpagesave, që tatimpaguesit do dorëzojnë elektronikisht pranë organit tatimor drejt ISSH", si dhe Aktmarrëveshja e përbashkët nr.4620/2 dhe nr.18534/4, datë 10.11.2011 "Për dërgimin nga drejtoritë rajonale tatimore në drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore të të dhënave, për kontributet e paguara nga çdo subjekt", shfuqizohen.
11. Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga palët.

PËR INSTITUTIN E SIGURIMEVE  
SHOQËRORE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME  
TË TATIMEVE

DREJTORE E PËRGJITHSHME

VASILIKA VJERO

